

Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit zhvillon workshop-et për planifikimin vjetor të auditimeve në vitin 2024

17 dhe 27 tetor 2023

Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (DATI) zhvilloi në datat 17 dhe 27 tetor 2023, në sallën e mbledhjeve në KLSH, dy workshop-e për procesin e planifikimit strategjik të auditimeve IT, për vitin 2024.

Këto takime erdhën në kuadër të planifikimit vjetor të auditimeve, si dhe matricën mbi të cilën do të mbështetet dhe dokumentohet i gjithë procesi. Ato kishin për qëllim diskutimin, vlerësimin dhe analizimin e fushave/subjekteve potenciale që mund të përfshihen në planin e ri auditues vitin e ardhshëm.



Në workshop-in e parë ishte i pranishëm i gjithë Departamenti dhe u diskutua mbi fushat potenciale të cilat mund të auditohen nga audituesit e Teknologjisë së Informacionit në vitin 2024. Nga fushat e diskutuara, marrë parasysh dhe kriteret e ndjeshmërisë publike dhe auditimit të tyre të mëparshëm ose jo nga DATI, spikatën ajo e shëndetësisë, arsimit dhe energjistikës.



Në workshop-in e dytë morën pjesë edhe dy auditues të Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional, znj. Miranda Misini dhe z. Idajet Kopani. Ky takim u fokusua në propozimet konkrete të dy apo më shumë auditimeve nga secili auditues i DATI-t.

Në vijim, DATI do të kryejë dhe përshkrimin e kontekstit social dhe subjekteve të propozuara nga secili dhe pas përzgjedhjes finale do të përgatiten kartat e auditimit për secilin auditim të planifikuar.